

Prokurimi publik paraqet njërin ndër aktivitetet kryesore ekonomike të komunave dhe si i tillë po ashtu paraqet një ndër rreziqet kryesore në drejtim të ofrimit të shërbimeve kualitative për qytetarët.

Me qëllim të identifikimit të shkeljeve në aktivitete të prokurimit publik dhe me qëllim të ofrimit të të dhënave të argumentuara për shkeljet të cilat ndodhin në prokurim, humbjet dhe dëmet e shkaktuara në buxhet, D+ ka monitoruar nga nëntë aktivitete të prokurimit në këto komuna. Përjashtimisht, në Komunën e Pejës janë monitoruar pesë aktivitete të prokurimit, pasi që në kohën e fillimit të fazës së monitorimit, komuna nuk ka pasur më shumë projekte në zbatim.

Paraprakisht, D+ ka publikuar “Matësin e Prokurimit Publik” i cili ka pasur për qëllim identifikimin e praktikave të mira në prokurimin publik në këto pesë komuna. Qëllimi i këtij raporti ishte që praktikave të mira të identifikuar në cilëndo nga këto pesë komuna të mund të vlerësohen dhe të ndahen me autoritetet e tjera kontraktuese.

Në këtë raport, D+ është fokusuar në identifikimin e shkeljeve në prokurim publik, sidomos në rastet kur kemi të bëjmë më humbje apo dëmtim të buxhetit të komunës.

Si rezultat i punës së D+ në monitorimin e prokurimit publik në nivel komunal, të paktën 36,684 euro të parave të taksapaguesve u kursyen.

Monitorimi theksoi gabimet në faturim nga një kontraktues, të cilat më herët nuk janë identifikuar nga Komuna e Prishtinës. Pas kësaj, Komuna planifikon të ndër marrë masa korrigjuese, duke ndryshuar kontratën për të rregulluar përshtatjen e çmimit dhe rimbursimin e parave të humbura të taksapaguesve.

Ky është vetëm një shembull se si monitorimi nga shoqëria civile mund të përdoret si një mjet nga komunat në adresimin e dobësive të sistemeve të tyre të brendshme.